URDHËR
Nr.571, datë 15.12.2010

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË "MASTER I SHKENCAVE" NË FAKULTETIN E EDUKIMIT DHE SHKENCAVE SHOQËRORE TË UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTËR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 26 dhe 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen në Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore të universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, të programeve të studimeve të ciklit të dytë "Master i shkencave" në:

a) "Gjuhësi", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare "Master i shkencave" në "Gjuhësi".

b) "Letërsi", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare "Master i shkencave" në "Letërsi".

2. Programet e studimeve të ciklit të dytë realizohet me 120 kredite, ku përfshihen 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike.

3. Programet e studimeve të fillojnë në vitin akademik 2010-2011.

4. Efektet financiare, për zbatimin e këtij urdhri, përballohen nga buxheti i universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, pa efekte buxhetore shtesë.

5. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj